



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa
Prishtinë, më 4.09.2007, ora 134:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë nga Komisioni: Naser Osmani Ali Sadriu, Besa Gaxheri, Snezhana Miliç Rifat Krasniq, Lutfi Zharku Safete Hadergjonaj, Gani Koci, Nazim Jashari, Mazllom Kumnova,

Ndërsa munguan, Demir Limaj dhe Naxhije Doçi,,

Nga zyra e komisioneve të Kuvendit: Ahtere Loxha Zyrtare Ligjore dhe Arta Hajra asistente Ligjore.

Mbledhjen e përcollën monitoruesit nga Presidenca OSBE, NDI
Mbledhjen e kryesoi kryetari i komisionit Naser Osmani

Kryetari hapi mbledhjen dhe propozoi këtë:

Rend Dite

- 1. Miratimi i Rendit të Ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt.23.08.2007.**
- 3. Njoftim lidhur me shqyrtimin e Pr/ligjit për Tatimin në vlerën e shtuar.**
- 4. Të ndryshme**

Kryetari pyeti anëtarët se a dëshiron dikush nga anëtarët të shtoj diçka në rend dite apo të miratohet me pikat e propozuara.

Kryetari konstatoi se Rendi i ditës u miratua si i tillë.

2.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Lidhur me procesverbalin Kryetari hapi diskutimin se a ka vërejtje nga anëtarët.

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje .

Kryetari para se të kalojë në pikën e tretë të rendit të ditës njoftoj se komisioni duhet ti shqyrtojë dy çështje të cilat nuk ishin paraparë në rend të ditës por të cilat janë urgjente, sepse njëra duhej të futet në rend dite për Kryesinë e Kuvendit dhe kjo është bërë me kërkesën e drejtorit të departamentit ligjor z. Daut Beqiri i cili ishte prezent .

1.Njëra tha ka të bëjë me kërkesën e Qeverisë për emërimin e anëtarit të propozuar të bordit drejtues të Autoritetit Bankar të Kosovës.

2.Kurse çështja tjetër tha se ka të bëjë me nenin 96.4 të Ligjit për prokurimin publik të cilën PSSP-ja e ka bërë një ndryshim gjatë nënshkrimit ,ndryshim i cili është bërë me kërkesën e AERI-të dhe çështja ka të bëjë me zgjedhjen e organit shqyrtues të pa varur, prandaj ne duhet ta respektojmë afatin kohor dhe ti rekomandojmë Kryesisë së Kuvendit ta filloj iniciimin e procedurës për emërimin e organit shqyrtues.

Gani Koci tha se sa i përket çështjes për emërimin e anëtarit të bordit, mund të jetë se është procedurë e përshpejtuar dhe mund të jetë kalim i afateve, por nuk mjafton vetëm njeriun me e njohtë si emër, pa pasur të dhëna të mjaftueshme për te dhe nuk jamë për atë që ta miratoj apo mos ta miratoj këtë propozim në komision , por komisioni lidhur me këtë çështje duhet ti rekomandoj Kryesisë ta vejë në rend dite për shqyrtim pa e cekë se u miratua apo nuk u miratua, kurse për çështjen e dytë ti rekomandojmë Kryesisë të filloj iniciimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të OSHP-së.

Lidhur me këtë u nxorr ky:

Përfundim

- 1. Ti rekomandoj Kryesisë që ta vejë në Rend dite në seancën e radhës propozimin e Qeveris për emërimin e anëtarit të bordit drejtues të Autoritetit Bankar të Kosovës dhe**
- 2. Ti rekomandoj Kryesisë që të filloj iniciimin e procedurës për zgjedhjen e anëtarëve të organit shqyrtues të pa varur sipas nenit 96.4 të Ligjit për prokurimin publik.**

Njoftim lidhur me shqyrtimin e Pr/ligjit për Tatimin në vlerën e shtuar.

Lidhur me pikën e tretë për shqyrtimin e Projektligjit për TVSH-ën **Kryetari** tha se pasi që ky ligj është i një rëndësie të veçantë e kam konsideruar të rëndësishme të ju njoftoj se deri në cilën fazë është punuar ky projektligj nga Virtyt Ibrahimaga i cili është angazhuar që propozimet e dhëna në debatet e mbajtura me OJQ-ët, me disa grupe të interesit dhe ndryshimet e propozuara nga grupi punues i komisionit ti inkorporoj në formë të amendamenteve ,materialin që e keni marrë nuk është version final por takimi ka karakter informimi. Lidhur me këtë hapi diskutimin.

Safete Hadergjonaj vlerësoi se në këtë mbledhje nuk mund të shqyrtohet ky Projektligj sepse tha se materialin e kemi marrë sot dhe nuk jemi të përgatitur në marrjen e vendimeve për ndryshime, sepse nuk kemi pas kohë me analizua paraprakisht.

Kryetari sqaroi se sot nuk është qëllimi ta shqyrtojmë Projektligjin por vetëm të njoftohet komisioni se në cilën fazë ka mbërrirë ligji, materialin që e keni marrë sot nuk është përfundimtar sepse është punuar deri te neni 20 dhe në mbledhjet e ardhshme Lutfi Zharku dhe Virtyt Ibrahimaga do ta pregadisnin versionin përfundimtar dhe do e sjellin në komision .

Lutfi Zharku tha pasi atë çka kemi punuar si anëtar të komisionit ne në grupin punues lidhur me

këtë ligjë e kemi krye dhe e kemi marr në versionin e spastruar dhe tani Virtyt Ibrahimaga është angazhua për t'ia dhënë versionin përfundimtar.

Virtyt Ibrahimaga kishte konstatuar se shumë amendamente janë paraqit në këtë ligj dhe shumë amendamente janë propozua nga grupi punues dhe tha se mundet deri në 50% me u ndryshua ky ligj, sepse ka shumë propozime dhe ka propozime për ndryshime rrënjësore të projektligjit .Më tutje tha se unë nuk propozoj amendamente të reja as për ndryshim të konceptit as për ndryshim të Ligjit po mundohem me i shkri të gjitha propozimet e dhëna dhe mos me e kundërshtua njëra tjetrën , më duhet edhe një herë të ulem me z. Lutfi sepse ka qenë bartës i shumë propozimeve . Nuk mundem me garantua se ky ligj mundet me u bë i mir sepse ka ndryshime konceptuale në amendamente që pastaj pasqyrohen në nene tjera dhe duhet pas parasysh që ta ketë njëfarë koherence ky ligj.

Në vazhdim kryetari e autorizoi ta udhëheq mbledhjen Safete Hadergjonaj nënkryetare e dytë sepse Kryetari kishte dalë nga mbledhja.

Safete Hadergjonaj tha se që në fillim kur ka ardhë ky ligj opozita ka qen e vetëdijshme se ky ligj është dashtë të kthehet, sepse është një ligj që duhet të përpunohet dhe nuk është ligj që ia vlen për këtë periudhë kohore të miratohet . Si grup punues jemi përpjekur me bë përmirësime aty ku ka qen e mundur dhe diskutabile kanë qen neni 2 dhe neni3 .Ne ja kemi dërgua MEF të gjitha kërkesat nga OJQ-et ,nga komuniteti i biznesit dhe grupet tjera me interes dhe kemi kërkuar që të na japin një mendim lidhur me implikimet buxhetore për ti bërë ato ndryshime të cilat i kanë kërkuar OJQ-et dhe grupet me interes të shoqërisë sonë. Nuk kemi marrë përgjigje dhe atë çka e pash në atë material që e morëm sot është e pa pranueshme dhe jam kundër të miratohet me këto ndryshime, ne mund të marrim pjesë në debat dhe të shohim çka mundemi me ndryshuar.

Ali Sadriu pyeti z. Virtyt se a është duke punuar në bashkëpunim me MEF dhe a kemi ndonjë analizë paraprake të këtyre ndryshimeve që implikojnë .

Virtyt Ibrahimaga në përgjigjen e tij tha se MEF i ka premtuar në mbledhjen e kaluar se do ti sjell disa vërejte por nuk i ka sjell deri me tani asgjë dhe se ka punuar në bazë të propozimeve të grupeve të interesit dhe personave tjerë që ka qenë në mbledhjen e përbashkët. Vlerësoi se projektligji ka shumë gabime edhe gjuhësore dhe që do ta rrit numrin e amendamenteve ndoshta deri në 200.

Gani Koci lidhur me normen e TVSH-ës ,tha se problemi është se ka pas disa qëndrime që a të ketë një normë të TVSH-ës, apo disa norma dhe lidhur me këtë kemi kërkuar një sqarim nga Qeveria. Nëse shkohet me 15% siç është në Rregullore , pak vërej ndonjë ndryshim esencial , ne duhet të i shikojmë vendet e rajonit se a kanë shkallë një normëshe të TVSH-ës apo kanë 2 ose 3 shkallëshe varësisht nga mallrat dhe destinimet e tyre. Nuk konsideroj se për të gjitha mallrat në Kosovë norma e TVSh-ës të jetë 15%, do duhej një analizë nga MEF dhe subjektet tjera që mëren me këtë çështje. Nga Oda ekonomike kemi marrë propozime se për cilat raste dhe mallra do të jetë shkalla e normës së TVSH-ës. Duhet të mëremi vesh se a jemi për një normë të TVSH-ës apo jemi për përshkallëzim të normës së TVSH-ës,edhe në emër të grupit parlamentar dhe partisë demokratike të Kosovës jemi për 2 ose 3 norma të TVSH-ës dhe jo vetëm për një , kështu është në të gjitha vendet ku aplikojnë TVSH-ën dhe vendet e rajonit dhe ne nuk konsideroj se Kosova duhet e jetë e veçantë.

Ali Sadriu mendon se komisioni përfundimisht është i pa pregaditur për këtë takim dhe tha se në një takim tjetër kur e marrim material shtesë mund të diskutojmë lidhur me këtë Projektligj, sepse tani në këtë mbledhje çfarëdo vendimi që do e marrim do të jetë i ngutshëm , sepse ka të bëjë me çështje konceptuale sepse mund të dalim nga binarët nga ajo që kemi punuar atë gjatë në komision dhe të dalim me koncepte tjera, propozoj që paraprakisht ta shikojmë materialin dhe të vazhdojmë ta përmirësojmë ,apo eventualisht të kërkojmë nga Kuvendi që ligji të rikthehet në hartim të ri ,sepse nuk ka logjik që Pr/ligji ti ketë 30 nene e të epen 200 amendamente sepse atëherë e humb

konceptin .

Besa Gaxheri tha se duke pas parasysh se ky projektligj është i një rëndësie të veçantë, nuk kemi qenë serioz sa duhet , në veçanti MEF prandaj jemi këtu ku jemi , mendoj se ky ligj është dashtë me u punua prej fillimit me ekspert të fushës së caktuar e jo me hy në procedurë e të dalin ma shumë amendamente se sa nene, prandaj propozoj të fillohet të punohet seriozisht një ligj duke marr modele në regjion dhe duke pretendua të jenë kompaktibile me Bashkësinë Europiane.

Lutfi Zharku parimisht tha se po ka keqinterpretime apo keqkuptime, ne në grupin punues kemi punuar dhe jemi munduar ta bëjmë ligjin si duhet se sa vlerësohet ajo është diçka tjetër, çështja e krijimit të shkallës tatimore është çështje e politikës fiskale në të cilën komisioni duhet të vendos, ne kemi punuar se a dalin 200 nene apo më tepër kjo është një çështje tjetër, kurse sa i përket shkallës tatimore është çështje e politikës fiskale dhe për këtë komisioni duhet të vendos dhe mos ta përziejmë anën e punës së ligjit me çështjen e politikës fiskale Lidhur me punën që e kemi bërë unë me Virtytin në këtë projektligj, ne së shpejti do ta përfundojmë dhe në mbledhje të ardhshme do ta prezantojmë dhe do ta shqyrtojmë se a jemi të gjithë të pajtimit me ndryshimet e bëra kurse e ana e shkallëve tatimore mbetet mu shqyrtua ma ndryshe .

Gani Koci: Nuk e nënvlerësoj punën e grupit punues se ne jemi ndal nene për nen dhe jemi ndal në nenin 2 dhe 3 dhe kemi pas një pikëpyetje për këto dy nene dhe ka mbet që në nivele tjera që të diskutohet dhe nuk e di a është kërkuar nga MEF sqarim lidhur me këtë.

Safete Hadergjonaj u ndërlihdh dhe tha se ne në grupin punues kemi punua në të gjitha nenet dhe ne si grup punues pikërisht për nenet 2 dhe 3 kemi kërkuar nga ministria një mendim por nuk kemi marrë kurrfarë përgjigje, në ndryshimet që i pashë sot nuk shoh që është bërë ndonjë ndryshim dhe këtë e konsideroj edhe një herë si një neglizhencë nga ana e Qeverisë.

Virtyt Ibrahimaga amendamentet kanë të bëjnë për ndryshimet që ju bashkërisht i bëni nëse doni me pas shkallë të ndryshme tatimore dhe duhet të mirëni vesh paraprakisht që pastaj të zbërthehen në amendamente por para se ta bëni at marrëveshje ndoshta ju duhen më tepër informata sepse çdo ndryshim ka implikime buxhetore.

Pastaj janë edhe disa çështje tjera se a duhet me u lirua konsumatori apo ekonomia nga TVSH-ja ,por koncepti i TVSH-ës është mu lirua ekonomia,ose a duhet në çdo import me u llogarit TVSH-ja, pastaj a me e mbledh TVSH-ën në doganë apo jo.

Besa Gaxheri tha se po shihet se sot lidhur me këtë projektligj nuk mund të bimë vendim për ndryshime ,por këtu qëndron problemi edhe te politikat fiskale të cilat duhet të ndryshohen.

Pas diskutimeve të anëtarëve u nxorr ky:

Përfundim

Projektligjit për TVSH-ën mbetet të shqyrtohet për mbledhjen e ardhshme posa të kompletohet me versionin përfundimtar .

Mbledhja përfundoi në orën 13:40 .

**Procesin e hartoi
Ahtere Loxha**

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani